



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2022:064958

Datë: 07.03.2024

Numri i dokumentit: 05421859

P.nr.2022:100081

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Adem Shabani, me zyrtaren ligjore Arbelinda Tahiri, në çështjen penale kundër të pandehurit E.S., me vendbanim në Ferizaj Rruga “ ... ”, me këtë ka kryer në vazhdimësi Veprën penale Vjedhja e rëndë nga neni 315 paragrafi 2 nënë paragrafi 2.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, i akuzuar në bazë të aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.415/22 të datës 17.05.2022, ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor me pjesëmarrjen e prokurorit të shtetit Albert Zejnullahu, Përfaqësuesin e të dëmtuarës KEDS-it Q.S., të pandehurit E.S. dhe mbrojtësit të tij me autorizim Av. Vehbi Kashtanjeva, me datën 28.02.2024 të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 07.03.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurit:

E.S., me vendbanim në Ferizaj Rruga “ ... ”, i lindur më datë ..., vendlindja Prishtinë, nga i ati S., nëna S., e gjinisë P., tani me vendbanim në Ferizaj Rr. “...”, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer fakultetin juridik, i gjendjes së mirë ekonomike, numër unik DFE9..., me numër të letërnjoftimit ..., mbrohet në liri.

Konform nenit 362 par. 1 nën par. 1.1 të KPPK-së (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032),

REFUZOHET AKUZA

SEPSE:

-Nga data e pavërtetuar deri më datë 09.08.2021, në Ferizaj, rr “...” përkatësisht në lokalit të tij “ ... ” Sh.P.K, në vazhdimësi, ka siguruar shërbime për të cilat e ka ditur se mundësohet vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe ka shmangur pagesën për shërbime të tilla,

duke përdorë energjinë elektrike pa autorizim të furnizuesit të autorizuar, në atë mënyrë që i pandehuri ka bërë lidhje direktë në rrjetin elektrik jashtë pikës matëse dhe atë përmes një kabloje 4x16, me të cilat ka furnizuar pajisjet e lokalit si furrë pice, frigorifer, aparat për kafe, fritezë, ventilim dhe ndriçim, ashtu që personat e autorizuar të KEDS-it gjatë kontrollit kishin hasur në këtë keqpërdorim e ku si rrjedhojë e kësaj energjia e shpenzuar nuk është regjistruar fare në njehsorin elektrik me numër 04... (grupi tarifor ..02 afarist) dhe si pasojë të dëmtuarës KEDS- Distrikti Ferizaj, i ka shkaktuar dëm material në shumë prej 6316,83€, -

- me këtë në vazhdimësi ka kryer veprën penale Vjedhja e rëndë nga neni 315 par.2 nën par. 2.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

- Për shkak se prokurori i shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor është tërhequr nga akuza.
- Përfaqësuesi i të dëmtuarës KEDS-it. Distrikti në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridikeudhëzohet në kontest civil.
- Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë e ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.415/22 të datës 17.05.2022, kundër të pandehurit E.S., me vendbanim në Ferizaj Rruga “ ... ”, me këtë ka kryer në vazhdimësi Veprën penale Vjedhja e rëndë nga neni 315 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Gjykata me datën 28.02.2024 ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin kryesor, Prokurori i Shtetit Alber Zejnullahu, në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se gjatë shqyrtimit gjyqësorë u administruan provat siç janë dëgjimi i dëshmitarëve të propozuar nga prokuroria, si dhe dëgjimi i dëshmitarit të propozuar nga mbrojtja e të pandehurit, po ashtu u lexuan edhe provat materiale si procesverbali në vendin e ngjarjes, faturat, fotografitë, kalkulimi humbjeve të energjisë elektrike, dhe pas analizimit të tyre kemi arritur në përfundim se fare nuk është kontestuese se në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në aktakuzë është kryer vepra penale, por sa i përket veprimeve inkriminuese të të pandehurit E.S., nuk është vërtetuar se i njëjti e ka kryer këtë vepër penale, e kjo pas dëgjimit të dëshmitarit S.S., i cili edhe e merr përgjegjësinë dhe në mënyrë të detajuar ka paraqitur versionin se si e ka kryer veprën penale, e për këto veprime janë vërtetuar saktë nga dëshmitarët e KEDS-it Sh.S.1. dhe Sh.S.2. dhe provat materiale, andaj duke u bazuar në nenin 51 të KPPK-së, tërhiqem nga ndjekja penale ndaj të pandehurit E.S., pasi që nuk është vërtetuar se i njëjti nuk ka kryer këtë vepër penale, ndërsa me këtë procesverbal obligohen përfaqësuesit ligjor të KEDS, që të paraqesin kallëzim të ri penal ndaj personit S.S. e

me të cilindo të vazhdohet me procedurat e mëtutjeshme në prokurori, ndërsa sa i përket të pandehurit E.S. kërkojë nga Gjykata që të merr aktgjykim lirues.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës KEDS-it Distrikti në Ferizaj Q.S., deklaron se pajtohem me deklarinimin e prokurorit të shtetit. Mbrojtësi i të pandehurit deklaron se pajtohem me deklarinimin e prokurorit të shtetit.

I pandehuri E.S. deklaron se pajtohem me deklarinimin e prokurorit të shtetit.

Andaj gjyqtari i vetëm gjykues duke pasur parasysh se prokurori i shtetit, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka hequr dorë nga aktakuza PP/II.nr.415/22 të datës 17.05.2022, kundër të pandehurit E.S., për veprën penale që akuzohet, në kuptim të nenit 362 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të KPP-së ,(Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032) mori aktgjykim refuzues në këtë çështje penale.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e bazoi në nenin 453 paragrafi 1 të KPP-së.

Vendimi për kërkesën pasurore juridike është marrë bazuar në nenin 462 paragrafi 3 të KPP-së (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032).

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,

P.nr.2022:100081 me datë 07.03.2024

Zyrtare Ligjore

Arbelinda Tahiri

Gjyqtari

Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.